



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

KOMUNIKATË

24. 09. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e vetë të 33-të të mbajtur sot, shqyrtoi rekomandimet e Zyrës për Regjistrim të Partive Politike për certifikim. Drejtoresha e ZRPP-së, Miradije Mavriqi, i paraqiti rekomandimet për certifikim për 9 subjekte politike të cilat janë proceduar dhe mbi këtë bazë, kanë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me ligj që të certifikohen. KQZ, miratoi rekomandimet e zyrës dhe i certifikoi këto 9 subjekte nga të cilat 4 janë inisiativa qytetare, dhe 5 janë parti politike.